



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:111123

Datë: 05.08.2024

Numri i dokumentit: 06019918

CAP.nr.669/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin individual Adnan Konushevci, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KESco), me seli në P....., Bulevardi Bill Klinton, Nr. 5, Ndërtesa e Elektor Kosovës Kati i -VII-, kundër debitorit SH.M nga Komuna e L....., Rruga “Lidhja e Prizrenit”, me objekt të përmbarimit kërkesë në të holla, në shumën prej 1,814.55 euro, duke vendosur në lidhje me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.38/21 i datës 09.03.2023, me datë 05.08.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit SH.M nga Komuna e L....., Rruga “Lidhja e Prizrenit”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr. 38/21 i datës 09.03.2023, PRISHET dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin PPP.nr. 38/21 i datës 09.03.2023, e ka hedhur prapësimin e debitorit si të pasafatshëm, i ushtruar kundër urdhrit përmbarimor, P.nr.101/21 i datës 01.04.2021, i lejuar nga përmbaruesit privat SH.L në F.....

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ankesë ka parashtruar debitori për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe kontestimore, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën dhe të anuloj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën ta kthen rishqyrtim dhe rivendosi në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës

Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), ka gjetur se:

-Ankesa është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim pranë organit përmbartues, me datë 23.03.2021, Organi përmbartues me urdhrin, P.nr.38/21 i datës 09.03.2023, ka lejuar përmbartimin.

Debitori, ka parashtruar prapësim kundër urdhrin të organit përmbartues, me propozim që të aprovohet prapësimi si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbartimor.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, PPP.nr.38/21 i datës 09.03.2021, ka hedhur si të pasafatshëm prapësimin e debitorit, duke vendosur më saktësisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se debitori e ka parashtruar prapësimin pas afatit ligjor të paraparë me nenin 70 të LPP-së, ndërsa vërtetohet se prapësimi është dorëzuar te organi përmbartues me datë 17.05.2021, ndërsa urdhrin nga përmbartuesi privat debitori e kishte pranuar me datë 24.03.2021, që do të thotë se kanë kaluar më shumë se një muaj nga dita e pranimit të urdhrin nga debitori.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtari i Gjykatës së Apelit nuk e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 lidhur me nenin 160.4 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, si dhe nenin 110 të LPK-së, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe se nuk është zbatuar drejtë e drejta materiale.

Gjykata e Apelit duke i vlerësuar pretendimet ankimore të debitorit të parashtruara me ankesë gjeti se të njëjtat janë të themelta. Kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore si dhe të procedurës përmbartimore, duke mos i zbatuar si duhet, e si rezultat i kësaj ka çuar edhe te marrja e një vendimi të pa qëndrueshëm dhe kundërligjor.

Gjykata e shkallës së parë është mjaftuar vetëm me përfundimin se prapësimi është parashtruar pas afatit të paraparë ligjor, pa i vlerësuar mirë të gjitha shkresat që gjenden në lëndë dhe pa vërtetuar saktë se kush e ka pranuar urdhrin përmbartimor sipas fletkthesës së datës 24.03.2021, personalisht debitori apo dikush tjetër në emër të debitorit.

Nga shkresat e lëndës për Gjykatën e Apelit, rezulton të provohet se procedura komunikimit më palët në procedurë, nuk është bërë në përputhje me dispozitat ligjore, më konkretisht me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat e rregullojnë mënyrën e dorëzimit të shkresave e paraparë me nenin 110 të LPK-së, i cili përcakton se *“110.1 Padia, përgjigja në padi, letërthirrja për në seancë, urdhërpagesa, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilit lejohet ankim i veçantë, mjeti i goditjes së vendimit, i dorëzohet personalisht palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë të saj. Shkresat e tjera do t'i dorëzohen personalisht adresatit kur një gjë e këtillë shprehimisht parashihet me këtë ligj apo kur gjykata konkludon se për shkak të dokumenteve origjinale që i janë bashkangjitur shkresës që duhet dorëzuar, ose nga ndonjë shkak tjetër, nevojitet kujdes i shtuar.”*, paragrafi 2 i po këtij neni përcakton se: *“110.2 Në qoftë se personi të cilit duhet dorëzuar personalisht shkresa nuk gjendet atje ku duhet bërë dorëzimi, dorëzuesi do të njoftohet se kur dhe ku do të mund ta gjejë këtë person dhe do t'ia lejë ndonjë personi të theksuar në nenin 111 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji njoftimin me shkrim që për marrjen e shkresës të jetë në ditën dhe në orën e caktuar në banesën e vet, përkatësisht në vendin e vet të punës”,* paragrafi 3 përcakton se: *“Po që se edhe pas kësaj dorëzuesi i shkresës nuk e gjen personin të cilit duhet dorëzuar shkresa, atëherë ai do të veprojë sipas dispozitave të nenit 111 të këtij ligji, dhe kështu dorëzimi do të konsiderohet i kryer.”*, ndërsa neni 111 që i referohet paragrafi 3 i nenit 110 përcakton se: *“111.1 Po që se personi të cilit duhet bërë dorëzimi i shkresës nuk gjendet në banesën e vet, dorëzimi bëhet duke iu dhënë shkresa ndonjë anëtarit të rritur të familjes së tij, i cili ka për detyrë ta marrë shkresën në dorëzim, e po që se as këta nuk gjenden në banesë, shkresa do t'i jepet fqinjit, po që se pajtohet me një gjë të këtillë. Dorëzimi i kryer në këtë mënyrë konsiderohet i vlefshëm.”*

Në rastin konkret, Gjykata e Apelit gjen se është vepruar në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara sepse nga shkresat e lëndës, nuk mund të konstatohet se nga kush është pranuar urdhri i përmbaruesit privat. Meqenëse kemi pasur të bëjmë me urdhër për përmbarim, dorëzimi është dashur që të tentohet ti bëhet personalisht debitorit, apo të te njëjtit ti lihet njoftimi se ku mundet që ti marrë këto shkresa brenda afatit të përcaktuar kohor, sepse në këtë mënyrë se si është bërë dorëzimi i shkresave për Gjykatën e Apelit, nuk mund të konsiderohet si dorëzim i rregullt.

Duke pasur parasysh këtë gjendje të krijuar, Gjykata e Apelit vlerëson se një vendim i tillë i gjykatës së shkallës së parë në asnjë mënyrë nuk mund të qëndrojë dhe të vërtetohet si vendim i drejtë dhe i ligjshëm dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë në përputhje me vërejtjet e dhëna nga kjo Gjykatë, ashtu që fillimisht të eliminoj shkeljet e bëra gjatë procedurës, të vlerësojë se a është bërë dorëzimi i rregullt i shkresave tek debitori, të vërtetojë se çfarë relacioni ka debitori me personin që ka pranuar shkresat e lëndës e që nënshkrimi i tij figuron në fletë-kthesë të dërguar nga ana e përmbaruesit privat, e më pas të merr vendim të drejtë dhe të duhur gjithmonë duke u kujdesur se a i përmbushin elementet e përcaktuara me dispozitat e LPP-së, dokumentet në bazë të cilave bëhet propozimi për përmbarim, e në veçanti duke iu përmbajtur dispozitës së nenit 160 të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.669/2023 datës 05.08.2024

Gjyqtari
Adnan Konushevci